

VITI XVI, NUMRI 6 / QERSHOR 2012

# FOREVER



HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA



EAGLE MANAGERS RETREAT  
Sardinia, Italy - May 23-26, 2013

# Alternativat



**P**ak kohë më parë, u ktheva nga një takim i zjarrtë Rally botëror i Azisë, i zhvilluar në Hong Kongun prrallor. Çfarë qyteti magjepsës! Këtë kohë e shijova shumë, kohë që munda ta kaloj me menaxherët më të lartë të FLP të ardhur nga të gjitha anët e botës. Ishte mjaft frymëzuese të ndjeje energjinë, përkushtimin dhe pasionin e tuaj ndaj biznesit të Foreverit. Tashmë kemi mbrapa Rally-in e Afrikës, me të përfundon edhe periudha e rally-ve. Me këtë, në historinë e Foreverit, mbyllet një kapitull i rëndësishëm, sepse këto takime rajonale për një kohë të gjatë kanë përbërë një pjesë të rëndësishme të „kulturës” të Foreverit. Por sikundër e kam ndjerë disa herë gjatë vitit të fundit, ky ndryshim është parë me kujdes, është diskutuar e analizuar, dhe unë besoj se ky është një ndryshim i rëndësishëm tani që ne zhvillohemi e rritemi si kompani. Është momenti i duhur për të kaluar në strategjinë e takimeve Global Rally, dhe unë besoj se kjo formë do të jetë një stimul i madh për distributorët tanë në mbarë botën.

Gjatë udhëtimeve të kohëve të fundit kam lexuar librin klasik të menaxhimit të biznesit „Është mirë të jesh i Madh”, nga Jim Collins. Z. Collins dhe ekipi i tij kanë studjuar për shumë vite, pse disa kompani kanë kaluar me sukses nga të mesme në të mëdha dhe pse disa të tjera kanë dështuar në këtë kalim. Ata diskutojnë shumë arsye për këtë kalim të rëndësishëm, por mua më ka tërhequr në mënyrë të veçantë njëra prej këtyre arsyeve, ajo që ata e quajnë „koncepti i iriqit”

Kjo i referohet asaj se si menaxherët kryesorë të një kompanie e drejtojnë atë: si dhelptra apo si iriqi.

Dhelptra nxiton që të jetë e para. Ajo vrapon sa andej këndeje, nga një ide e madhe në tjetrën. Ajo gjithmonë vrapon për gjënë tjetër të madhe, për diçka që mund ti sigurojë shumë gjëra. Dhelptra do të provojë diçka dhe nuk i merr parasysht pasojat. Ajo egërsohet shpejt, bëhet e pakënaqur dhe çdo ditë thur plane të reja. Kjo tingëllon si shumica e bizneseve MLM që mbijnë befaz nga hiçi dhe dhe pastaj zhduken brënda një kohe të shkurtër; mbasi drejtuesit e këtij biznesi janë të paaftë për ndërtimin afatgjatë të tij.

Ndërsa iriqi ecën ngadalë e me kujdes. Çdo vendim që merr e peshon me kujdes, që të jap rezultatin më të mirë për biznesin e tij sipas situatës së krijuar. Ai e lë mënjanë çdo ide të tillë që nuk harmonizohet me interesat e biznesit të tij. Ndonse ai është i hapur për ide të reja, dhe rishikon aty këtu planet dhe biznesin e tij, e shih se nuk ka nevojë për ndryshime të mëdha e të panevojshme. Ai ecën hap pas hapi dhe përqëndrohet në atë që është më e mira. Kjo më ngjan tamam si me biznesin tonë të Foreverit. Për 33 vjet jemi rritur vazhdimisht në gjithë botën, por në mënyrë të qëndrueshme.

Me energjinë dhe dëshirën e vazhdueshme për të provuar gjëra që mund të përmirësojnë kompaninë, na pëshpërisin në vesh, se në qoftë se veprojmë si dhelptra mund të dalim fitimtar nga beteja. „Dhelptra” sukseset e saj dhe të biznesit të saj i bazon në atë që të jetë e hapur për çdo mundësi të re, dhe çdo mundësi të re ta provojë. Por më në fund del se kjo nuk është gjithshka, nuk është esenca. Ata që janë tipi i dhelptrës nuk kanë plane afatgjatë, nuk kanë ide konkrete, nuk e shohin qartë orientimin, që të çon ose do të duhej ti çonte tek biznesi.

Por nga beteja do të dalë fitimtar, tipi i iriqit, që ndërton një biznes të planifikuar, të menduar mirë dhe që ecën vazhdimisht. Ky tip i cakton vetes objektiva të tilla, për të cilat ia vlen të luftohet. E planifikon dhe e shikon të qartë rrugën si dhe mënyrën se si mund ta arrijë atë objektiv. Bëhet specialist për atë që bën dhe di se si mund të tërheqë edhe të tjerët në të. E ka të qartë cila është më e mirë për biznesin e tij, dhe nxjerr nga vetja më të mirën. I mendon deri në fund gjërat, para se të zgjedhë mënyrat për përmirësimin dhe rritjen e biznesit të tij. Qënia konsequent është çelësi i suksesit. Kjo është e vërtetë për çdo biznes deri tek biznesi i rrejtndërtuesve të Foreverit disa milardshe. Pa dyshim, që teknikat që vënë në lëvizje biznesin tonë, gjatë viteve kanë ndryshuar shumë. Interneti, komunikimi global, për të gjithë ne kanë sjellë mundësi të reja. Por ndërkohë duhet të kujtojmë se biznesi i fuqishëm i FOREVERIT është ndërtuar dhe ndërtohet edhe sot mbi komunikimin personal. Kjo ka qënë dhe mbetet edhe sot baza e këtij biznesi. Ka rëndësi që këtë të vërtetë ta ndani edhe me të tjerët. Ta ndani me ta, që kur edhe ata të bëhen vetë drejtues tua thonë këtë edhe të tjerëve.

Në qoftë se ndjek këtë parim bazë të thjeshtë, kjo do të ketë një ndikim të madh dhe mbani gjithmonë parasysht që në gjithshka që bëni të krijoni madhësi.

  
REX MAUGHAN

I JUAJI PËRGJITHMONË



# Zgjedhja



**J**eta jonë e përditëshme është e mbushur plot kufizime, me leje të vërteta dhe të imagjinuara, me limite, media zbraz mbi ne lajme gjithnjë e më negative, me të cilat provon të vendos kufizime të reja mbi jetën tonë.

**KUFIZIMET I NDËRTOJMË BASHKË ME MENDIMET TONA** – kufizimet duhen shëmbur bashkë me mendimet tona.

Atëhere përse bëhet fjalë? Çdo ditë marrim shumë lajme. Disa herë këto lajme nuk mund të klasifikohen, nuk mund të kontrollohet përmbajtja e realitetit dhe vetë ne vendosim se ku do të vëmë ato. Lajmet që sjellin kufizime, thjesht duhen hedhur në PLEHRA. E dini, ashtu si në kompjuter, dhe kur mbushet, hidhini bashkë me plehrat. Hapni një kosh të ri plehrash, sepse lajme të këqija do të ketë gjithmonë, prodhues të lajmeve të këqija ka gjithmonë, por mund të arrish në një nivel të atillë, kur këto as nuk ke për ti dëgjuar, dhe e di, që jeta jote do të jetë shumë më e bukur. Egzistojnë veçanërisht edhe „lajmëtar“ negativ. Ata, unë i dëgjoj duke buzëqeshur, por nuk arrijnë kurrë deri në ndërgjegjen time. Krijë një klasifikim të brendshëm, i cili bën të mundur, që vetëm mendimet e mira dhe të bukura të hyjnë në ndërgjegjen tënde. N qoftë se jeton në një familje të bukur, i rrethuar nga fëmijët, miqtë, të dashurit dhe krijoni një harmoni të përbashkët, atëhere këta lajmëtar dhe këto mendime të këqija as nuk mund të hyjnë tek ju. Mbajni ato larg jush. Ne televizorin e përdorim vetëm për të parë filma. Lajmet nuk arrijnë deri tek ne, kështu që nuk mund të shqetësojnë jetën tonë të qetë. E imagjinon dot që edhe ti të jetosh kështu? Jetojmë në një sezon shumë të bukur, fushat madhështore gielbërojnë, çdo mëngjes zgjohesh me këngën e laureshës së fushës, vëzhgon, se si lulëzojnë lulet e kopshtit, pemët, se si shfaqen frutat e para, toka ka aq shumë vlera të rëndësishme! Përrenjtë e pastër gurgullojnë, dhe NJERËZIT E MIRË bashkëbisedojnë. Kërko shoqërinë e këtyre njerëzve, kërko ata që janë si Ty, dhe mund të jetosh një jetë pa probleme!

Në dorë ke një mundësi të jashtëzakonshme, KY ËSHTË FOREVERI. Këtë mundësi nuk duhet vetëm ta ruash dhe ta trajtosh, por puno për të, zhvilloje, dhe mbi të gjitha ndaje me të tjerët çdo ditë. Në do të bësh këtë, atëhere nuk do të kesh kohë për të dëgjuar lajmet e këqija dhe lajmëtarët budallenj. Jeto jetën tënde! Jeto atë, që do të dëshiroje me të vërtetë, shëmb kufizimet, zhvillo sistemin e mendimit, që të jesh mjaft i fortë, që ta realizosh këtë. Nëse duhet, çdo ditë jeto pak brenda saj. Mund të jetosh një jetë të ekuilibruar, të sigurt, të qetë, mund të shijosh frytin e punës tënde, LIRINË pa kufizime. Tani nuk them atë, që mendohu për këtë, nuk jap mundësi zgjedhjeje, sepse unë vetëm të mirën ofroj për ty. Zgjidh lirinë! Përpara Forever Hungari!

DR. SÁNDOR MILEȘ  
DREJTORI PËRGJITHSHËM

**HAWAII  
GLOBAL RALLY  
2013  
21-29 APRIL**





Happy  
15  
Birthday

Success Day

15  
**FLP E HUNGARISË 15 VJEÇE**

Njëra festë ndjek tjetrën. Sapo kemi kaluar përshtypjet e Rally-it European, ky jubile jep arsye për nostalgji. Sivjet mbushen 15 vjet nga koha kur erdhën kutitë e para Touch tek ne. 15 vjeçe është edhe Forever Living Products Hungari. Nga filluesit e asaj kohe sot në skenë nuk figuron vetëm një si diamant menaxher.



**G**éza Varga, soaring menaxher si gdhendës i drurit, sot në Forever e konsiderojnë „gdhendës të njerzve”. **Dr Ilona Juronics** si mjeke pediatre, ku ngritjen e vërtetë ia solli Foreveri. Prej vitesh janë anëtarë të Klubit të Presidentit. Sot në Ditën e Suksesit jubilar janë ata drejtuesit e programit. „Ky 15 vjetor nuk mund të ekzistonte pa ju”, me këto fjalë e hapin ata aktivitetin. Forever Living Products Hungari ekziston prej 15 vjetësh duke ndjekur misionin e krijuesit të kësaj firme **Rex Maughan**, krah për krah me vendet e rajonit dhe vendet e tjera të kontinentit. Ilona rezultatin më të lartë të një dekade e gjysëm konsideron ndryshimin që distributorët sollën në jetën e të tjerëve. „Duket si endërr ajo që është realizuar, i kemi kthyer këtij profesioni prestigjin dhe tani nuk ka mundësi më të mira biznesi se sa Foreveri. Ka shumë rëndësi që ta bëjmë në mënyrë profesionale ose hiç fare dhe kjo ditlindje mund të jetë percaktuese e fatit. Si shqiponja e kemi nisur dhe betohemi se kështu do të vazhdojmë!” – e mbyll fjalën e saj Ilona, pastaj thërret në skenë violinistin **Edvin Marton** i cili ka ardhur me një orkestër të plotë simfonike dhe na jep një shfaqje të vërtetë, duke i rënë violinës edhe në rreshtat e pjesmarrësve. „Eshhtë fantastike të qëndrosh këtu edhe pas 15 vjetëve!” – e fillon përshëndetjen e festës **Dr Sándor Milesz**, drejtor i përgjithshëm, dhe pastaj flet për drejtuesit më të lartë të kompanisë. „Faleminderit sponsorit tim Rex Maughan, i cili është sponsori më i mirë në botë, njeriu më i mirë në botë. Shumë kam përfituar prej tij. Jam krenar për këtë dhe përpiqem të jetoj ashtu si edhe ai. **Gregg Maughan**, si një president me vizion e drejton me aq energji Foreverin duke na bërë të pandalshëm. Nën drejtimin e zëvendës presidentit **Aidan O’Hare**, në vitin 2011 Europa pati



në këtë biznes një rritje prej 9,5%. Kriza nuk ka të bëjë me ne, ajo ekziston vetëm në media!"  
 Në këtë çast, për ti befuar po lidhemi online me qendrën e Foreverit në Phoenix; në ekran shfaqet fytyra e Gregg Maughan dhe Aidan O'Hare., „Kurrë nuk do ta harrojmë Rally-in e fundit Europian dhe e vlerësojmë shumë punën dhe përpjekjet tuaja me të cilat dëshironi të arrini të jeni të parët në botë” – na drejtohen drejtuesit e kompanisë të gjithë neve dhe nëpërmjet nesh gjithë distributorëve të Hungarisë dhe të vendeve të tjera të rajonit. Falnderim i vecantë u takon atyre që janë këtu që në fillimet e firmës, dhe prej 15 vjetësh me përvojën e tyre na mbështesin. Shkëlqen papërkulshmëria e **József Szabó, Miklós Berkicsit**, lufta e **çiftit Lomjanski** për mposhtjen e çdo vështirësie, rezultatet e **familjes Gidófalvi**. „Një ëndërr u bë realitet, mesazhi u nda me njerëz të panumurt se si mund ti ndihmojmë. Kjo është një jetë e mrekullueshme, që do të thotë Forever!”

Dr Sándor Milesz thekson se FLP e rajonit ka drejtues të tillë me njohuri dhe aftësi që janë të veçanta në botë. Për këtë drejtor rajonal nuk kënaqet me pak. „Edhe tre herë nga pesëmbëdhjetë vite mund të vijmë, po të varet nga unë, - thotë ai dhe thekson: „unë dua të jemi vetëm të parët, mua asnjë numur tjetër nuk më pëlqen. Dua të jemi të parët në Europë dhe në botë! Në qoftë se do të jemi plot me diamantë, botën do ta udhëheq një rajon diamantësh!”

Pas ndjenjave dhe festimit rikthehemi tek bazat e specialitetit të shëndetit, flet **Dr Terézia Samu**, soaring menaxhere, fytyra e mjekut të Foreverit” Fillimisht

si kirurge e venave ishte skeptike, por forca e bimëve medicinale dhe përvoja me produktet e bindën dhe kështu ju hapën perspektiva të reja për gjithë jetën: „ në punën time gjithshka bëja nuk kishte ndikim të vërtetë afatgjatë mbi gjëndjen e pacientëve. Këtë gjë e ndryshoi kur me ndërmjësimitin e **Ágnes Krizsó dhe János Szabó** në jetën tonë u fut Foreveri, me anën e të cilës mund të krijohet një mirqënie komplekse si trupore, shpirtërore e sociale. Çfarë u kam dhënë të tjerëve me këtë? Mundësitë e prevencionit të sëmundjeve dhe një plan marketingu për një jetë cilësore. „ Kjo mund të shihet edhe nga kapitujt më të fundit , jeta e Terézia Samu në foto: Ditlindja në malet e larta Tatra, çaste në stadiumin Arena, rrugtimi me anije, dorëzimi i çekut Profit Sharing, miqtë, familja. Dhe e gjithë kjo falë një bime të veçantë medicinale që largon helmet, që ushqen e harmonizon funksionet jetike. Kjo është Aloe Vera. Pastaj vazhdon bateria më e madhe dhe më e re muzikore. Këndon **Attila Pataki**, pastaj si model për shumë vetë, vjen Miklós Berkics, dhe jo si do kudo.

Një veturë Porsche me targa FLP xhiron para skenës. Prej saj zbret **József Szabó**, themeluesi, i cili solli në kohën e vet në Hungari mundësinë Forever. Dhe ashtu si ai, pas Józsefit vjen me një Porche më të re Miklós Berkics, kështu dyfishohen njerzit në këtë biznes. Pas serisë së parë të leksioneve në CD Turbo





Start, vjen Turbo Start 2.0 që përmban leksione për ndërtimin e rrjeteve nga drejtuesit më me emër në Forever. Ftesa, prezantime, ngjitje, konsultime, ndërtim rrjetesh në gjerësi e thellësi, lojë në skuadër... këto janë llaç, tulla me të cilat mund të ndërtojmë kala. Tani i duhet vetëm çatia dhe nuk është sekret që sipas Miklós Berkicis: atë që kemi filluar të mos e lëmë përgjysëm. „Më në fund kemi një gjë që mund ta bëjmë deri në fund!“ Sipas diamant menaxherit në Forever i vjen radha gjithkujt. „Siç plotësohet personaliteti yt, ashtu vjen edhe rezultati. Unë përshembull bëj atë që funksionon, prandaj jam këtu me këtë Porsche“ – thotë Miklós, problemi i të cilit vetëm kaq ka kuptim: pro- domethënë provë para një detyre vërtet të madhe.

Pas mendimeve të Miklós mund të dëgjojmë mesazhin festiv të **Rex Maughan**. Kreu i familjes Forever ju uron sukses edhe për 15 „vitet e ardhshme Forever“. „Kam besim se do ti zgjidhni të gjitha detyrat“ – u thotë personalisht të gjithëve... „Go Diamond, bëhuni diamantë!“ Dikush besoi para 15 vjetëve që ajo „kuti“ do ta bënte të lirë dhe të pasur.

Ai ishte **József Szabó**, që tani është zafir menaxher, lektori i parë i Ditës së Suksesit jubilarë. „Kam besuar që kjo do të jetë një ishull në rajon, për ata që duan të realizojnë veten.. Por duhet një ëndërr! Përcille edhe ti këtë shans dhe do tia arrish suksesit! Gjej diçka që imagjiron, krojo qëndrueshmëri, dhe në jetën tënde do të shfaqet zjarri, në qoftë se ti e ndez. Paratë i bën ti, biznesin e bën ti, dhe nuk ta bëjnë të tjerët. Në qoftë se ke miq do të kesh edhe para, ndryshe nuk ecën!“ József Szabó vlerëson punën edhe të distributorëve më të thjeshtë: „pa juve nuk do të kishim ecur“, - thotë ai, pastaj përmend kolegët që ishin pjesë e suksesit të tij: **Dr Sándor Milesz, Dr Gabriella Kassai, Miklós Berkics, Ágnes Krizsó**. Ju premtoj se nuk do tju lë vetëm sepse kjo është një botë e mrekullueshme!“

Se si vështirësitë dhe sfidat ikin me atë, që njeriu merr një vendim të mirë, atë nuk mund të na i sigurojë si shëmbull më mirë se zafir menaxheri **Tamás Budai**. Babai i tre fëmijëve e ka kaluar periudhën e betejës. Tashmë edhe vetë është në gjendje të flasë për të, sepse luftoi dhe fitoi në një situatë kur shumë të tjerë ndoshta do të ishin dorëzuar. Por ai ka lindur luftëtar. „Së pari duhet të ruani veten , sepse jeni model për njerzit.





Duhet të rezistoni, edhe në qoftë se ka probleme. Mua më thanë se mbas dy muajsh do ta dëgjojmë këngën. Por unë kisha premtuar që do të arrij zafir menaxher, sepse nuk doja të isha i pesti apo i pesëmbëdhjeti, por vetëm i pari. U bëra pjesë e „Klubit të Conquistadorëve” dhe nuk kish më „do të doja” por „dua”, kështu u arrit dhe kualifikimin e prita me kaq dashuri sa them: ia vlen ta çoj deri në fund. Bëje edhe ti, ji sistematik, i frymëzuar, i trainuar. Edhe mbas 20 vjetësh me ju do të jem, sepse kjo është një skuadër e mirë dhe nqse u bë një diamant, atëhere kushdo mund të bëhet.” Më tej në skenë ngjiten luftëtar të mëdhenj: **Péter Lenkey** menaxheri i përgjithshëm dhe drejtorët rajonalë, **Tibor Kiss, Kálmán Pósa, Tibor Radóczy, Branislav Rajić, Slavko Paleksić, Andrej Kepe, Dr. László Molnár, Aleksandar Dakić, Attila Borbáth**. Para gjithë ekipit të drejtuesve, soaring menaxheri **Tibor Lapicz** shpalli të kualifikuarit e periudhës. Shou spektakolar i Sonya-s dhe formacioni i **Tre Tenorëve të FLP, Miklós Berkics, Tibor ÉliásLajos Túri Lui**, priten me duartkrokje të mëdha dhe më tej dëgjojmë leksione të tjera motivuese.

„Instiktivisht” u bënë diamantë çifti **Lomjanski: Veronika dhe**

**Stevan**- të paktën ata e thonë këtë. „Nuk na interesonte ç’thoshin të tjerët dhe nuk e lamë këtë punë, se janë rrethana të vështira”, - thekson Veronika në leksionin që pason, “Thjeshtë donim, donim të ishim më të mirët dhe kjo shmangu çdo pengesë. Me këtë firmë ishte e lehtë sepse ka sistemin më të mirë të marketingut”. Sipas Veronika-s kush jeton me frikën e dështimit, kjo ka vetëm një arsye: ti vetë ke ngritur rreth teje mure. „Fshiji nga vetja cmirën, inatin, më mirë bëj tërheqje atë që bën. Në vend që të hiqesh i zgjuar, puno! Ambicia është më e rëndësishmja. Mua përshembull mu krijua bindja që unë jam më e mira, zonja më e zgjuar në botë, megjithse nuk i di të gjitha. Jini të singertë me veten: po për para e bëj, se me ato mund ti ndihmoj më shumë të tjerët, në vend të ankesave përcill buzëqeshje. Mbajeni shënim: për suksesin e kësaj pune nuk ka sekret, në qoftë se keni një sistem, një prapavijë mbështetse dhe qëndrueshmëri. Çlirohuni nga idetë e fiksuara dhe lere të lirë tek vetja gjeninë, sepse gjeni je! Le të kemi në rajon të paktën 50 diamantë menaxherë! – uron në mbyllje diamant menaxherja Veronika Lomjanski, të cilën e pason një diamant tjetër, diamanti **Attila Gidófalvi**, i nderuar në mbarë botën. Ai ka një të shkuar vetëm 4 vjeçare në Forever, por ka plane afatgjata, ai me vetëdije, nga ofertat e ndryshme zgjodhi këtë firmë MLM. „Jam krenar që mund të punoj në këtë firmë. Paret që marr këtu në një muaj, tjetri i merr për 3 vjet. Ime shoqe thotë se më mirë të kemi 10 vetë që na kanë zili sesa një që i vjen keq. Por secili aq biznes ka sa i mban personaliteti i tij. Duhet







përkushtim dhe pasion që të mund të tërheqësh njerzit dhe gjithmonë do të arrish atë që je vetë." Sipas Attila çdo ditë ia vlen të pyesësh veten: E ke provuar mirë? E ke bërë mirë? A je vetë gati? „Duhet të luftojmë çdo ditë për të qënë më mirë, nga kjo vjen xhiroja, dhe për këtë të tjerët e shohin që ia vlen të qëndrojnë me ty. Mëso ta ndërtosh këtë biznes jo për para por për çastin. Por duhet vendosur , cili është roli yt në këtë jetë, sepse nuk

ia vlen as bicikleta më e mirë në botë, në qoftë se nuk ka kush ta ngasë. Me këtë synim duhet ngritur nga gjumi e duhet rënë për gjumë, mbasi ndërtimi i rrjeteve përcakton jetën e njerzve. Për atë kohë sa është i rëndësishëm shëndeti dhe bukuria, për atë kohë duhet të funksionojë ky biznes. 15 vjet apo edhe shumë pesëmbëdhjeta të tjera. Pyetja shtohet ti a do të mund ta vesh në funksionim." Ditlindja e firmës mbyllet sipas modës me tortë e fishekzjarre Nga podiumi i më të mirëve ju urojmë të gjithëve shumë herë 15 vjetore me Foreverin!



## FLP-lexikon

### 4.03 Kualifikimi "Aktiv"

(a) Për tu kualifikuar për të gjithë bonuset dhe stimujt, me përjashtim të bonusit personal, bonusit të distributorit të ri dhe fitimin nga çmimi i distributorit të ri, Drejtuesi i Shitjeve duhet të kualifikohet si distributor aktiv, dhe të plotësojë të gjitha kërkesat e tjera të Planit të marketingut gjatë muajit kalendarik në të cilin përllongariten bonuset.

(b) Për tu kualifikuar aktiv për atë muajin, drejtuesi duhet të ketë gjithsejt 4 pikë (CC) brënda vendit, ku të paktën njëra duhet të jetë pikë personale.

(c) Drejtuesi i shitjeve që nuk plotëson statusin aktiv, nuk do të paguhet bonusi i volumit nga grupi për atë muaj, dhe nuk do të konsiderohet drejtues aktiv i shitjeve. Në këtë rast bonusi i tij i paguhet drejtuesit tjetër aktiv në linjën e sipërme e kështu me radhë.

(d) Një drejtues shitjesh që humbet ndonjë bonus volumi, mund të rikualifikohet në muajin pasardhës si drejtues aktiv i shitjeve, (pa kërkuar prapaveprim).



# FOREVER DITA E SHËNDETIT

BUDAPEST, 13 MAJ 2012

Para dy vjetësh Dita e Shëndetit në Forever ishte një gjë e re, por tani e di gjithkush se çfarë përfitohet në këtë takim vërtet të dobishëm ku ata që janë në rolet kryesore na bëjnë të njohura faktet dhe gjithshka mund të dimë për funksionimin e organizmit tonë, për problemet dhe parandalimin e tyre me mjete më natyrale.



**P**rezantim produktesh, paisje diagnostikimi nga më modernet, vlerësim i gjendjes nga konsulentë të mjekësisë alternative, kontroll i përgjithshëm mjekësor, dhurim gjaku, dhe leksione për ruajtjen e shëndetit, të mbledhura në një Ditë Shëndeti të Foreverit. Vjet dhe parvjet programi u zhvillua në mjedis të hapur duke u rrezikuar nga koha e keqe, ndërsa sivjet takimi u zhvillua në qendrën Syma ku **Enikő Détár dhe Károly Rékasi** bënë hapjen. „Vjen njeriu që ka sukses në gjithshka”,





me këto fjalë ata ftojnë në skenë drejtorin e përgjithshëm, **Dr Sándor Miliesz**. Por kimisti-mjek natyralist, anëtar i Urdhërit Kalorsiak të Maltës, fitues i çmimit Pro Natura, babai i 5 fëmijëve, nuk është vetëm drejtues i firmës por edhe rrjetndërtues i sukseshëm dhe zafir menaxher. – Kjo ditë flet për shëndetin, ndërsa shëndeti është baza e mirqënies., e fillon ai fjalën e tij ai. Gjithmonë kërkojmë njerëz të tillë që do të donin të jetonin ashtu si edhe ne. Në harmoni trupore e shpirtërore dhe në paqe. Mbase sëmundjet vijnë gjithnjë nga mungesa e diçkaje, shumë herë shkakun janë problemet e të ushqyerit. Por në qoftë se organizmi i merr të gjitha lëndët ushqyese, atëherë sistemi imunitetit na mbrohet. Për këtë i duhen vitaminat, lëndët minerale por edhe ushqimi shpirtëror. Ta ndajmë këtë mundësi të jetës së pastër me sa më shumë njerëz!

Drejtori pyet se kush në sallë e ndjen veten të shëndetshëm, më pak vetë ngrihen në këmbë nga ata që janë ulur. – Ju uroj që në Ditën e ardhshme të Shëndetit, të gjithë të ngrihen në këmbë që të mund të thotë: jetoj në harmoni dhe prej meje rrezaton dashuria!

Fillon seria e leksioneve për problemet e shëndetit, mjekë shkencorë dhe natyralistë flasin për përvojat më të reja në fushat e tyre. – Me stërvitje e me mësim të jetojmë në shërbim të të tjerëve. Ky është misioni ynë thotë mjeku specialist i pavarur i Foreverit, mjeku shkencor dhe natyralist **Dr György Bakanek**. –Eshtë një gjë e lartë të kontribuosh për lumturinë dhe shëndetin e njerzve, por për këtë njeriu në radhë të parë duhet të marrë në dorë shëndetin e vet – thotë ai. Ai e konsideron që shëndeti është një projekt që duhet ta planizojmë dhe realizojmë me vetëdije.



1. Dr. Sándor Miliesz, 2. Enikő Détár , Károly Rékasi , 3. Dr. Terézia Samu, 4. Dr Edit Révész Siklósné , 5. Dr. György Bakanek, 6. Dr. Mária Hocsi

„Në jetë vetëm ai mund të jetë i sukseshëm që ka projekte. A jeni gati ta bëni për këtë? – pyet György Bakanek, sipas të cilit ushqyerja, lëvizja, paksimi stresit dhe çlirimi nga lëndët e dëmshme janë kyçi i suksesit. Theksin duhet ta vëmë tek konsumi zarzavateve dhe proteinave të pastra shtazore, krahas të cilave mund të pihen plotësuesit dietik cilësorë. Por kjo tani është e pamundur, mbasi përmbajtja e lëndëve ushqyese tek frutat dhe zarzavatet në dekadat e fundit është pakësuar rrezikshëm. „Të shesësh produktin është e vështirë ndërsa planin shëndetsor është më e lehtë, atëhere përqëndrohuni tek kjo”, këshillon lektori.

Gjithnjë e më tepër dimë për shëndetin, megjithatë sëmundjet popullore përhapen, madje edhe në rrethin e fëmijve, tërheq vëmendjen **Dr Edit Révész**, mjekë specialiste e anesteziës dhe e reminacionit, soaring menaxhere, kryetare komitetit të mjekëve specialistë të Foreverit. Kjo është një punë me shumë faktorë: origjina gjenetike, imunologjia, faktorët shpirtërorë, shkaqet hormonale mund të luajnë rol njësoj në shkaktimin e problemeve shëndetsore. Ajo që mund të bëjmë kundër tyre është që në ushqyerjen tonë të rikthehemi te bazat e vjetra, të lëvizim çdo ditë dhe të marrim vitaminat e nevojshme. Dr Edit Révész detajon lëndët e shumëllojshme të dobishme, duke folur për Vitaminën D, për rolin e proteinave, për acidet dhjamore Omega-3, për bioflavonoidet, për antioksidantët, për pre- dhe probiotikët. Por mjafton të respektojmë rregullin bazë: më shumë proteina, më pak yndyrna, dhe akoma më pak karbohidrate, në ushqyerje kjo është kryesorja që duhet respektuar. Përsa i përket produkteve të qumështit, Dr Edit Révész, rekomandon përdorimin me kujdes, ndërsa përsa i përket karbohidrateve rekomandon vetëm ato me cilësi të mirë, por sido që të jetë, kjo është e vërteta në çdo ngrenie tonën: krahas raporteve dhe përbërjeve të duhura, cilësia mbetet fjala kyçe. Kjo nuk është e vërtetë për ne njerzit, por edhe kafshët e preferuara shtëpiake. Këtë na tregon për to mjeku veteriner **Dr Ottó Kertész**. Edhe tek kafshët nevojat bazë janë të njëjtoja: shëndet i trupit, shëndet shpirtëror e social. Edhe në zhvillimin e sëmundjeve ndiqen mekanizmat e përvojës të njeriut dhe kështu shumë herë produktet e efektshme për njeriun janë të pështatshme edhe për parandalimin e sëmundjeve të kafshëve.

Pas shfaqjes spektakolare, akrobatike të **Vegas Show Band**, mban leksionin e vet menaxheri Imre Meggyesi duke folur për „lirinë sportive”. Tashmë të gjithë e dinë se pa lëvizje sistematike nuk ka shëndet, por nuk e kuptojnë të gjithë njëjloj çdo të thotë sistematike. Në Hungari vetëm 28% e të rinjve merret me sport dhe kjo nuk është dhe aq pak krahasuar me 5% tek të rriturit e moshës 16 deri 60 vjeç. Por ky nuk është qëllim në vetvete dhe nuk është mjaft për një jetë intensive, sepse njerzit që u mungojnë vitaminat, aminoacidet, dhe lëndët minerale nuk kanë vërtet energji dhe nuk kanë qejf të merren me sport, dhe sigurisht është i nevojshëm edhe menaxhimi i kohës që program të koordinohet edhe me nevojat e punës dhe nevojat familjare. **Imre Meggyesi** prezanton ato preparate ndihmuese të sportit me të cilat Foreveri mbështet për një mënyrë jetese aktive.

**Dr. István Taraczközy**, kryetar i Shoqatës të Mjekësisë Alternative Hungareze i befason dëgjuesit me një temë të veçantë. Biologjia në zgjedhjen e partnerit. Ai flet për elementët e fshehtë të afrimeve dhe largimeve njerëzore: për rolin e erës të trupit dhe të aura-s. Sikurse është vërtetuar në eksperimentet me kafshët ashtu edhe në testet sociopsikologjike, sinjale të vecanta gjenetike mund të kenë rol të



fugishëm në formimin e lidhjeve tona dhe mund të njohim nivelet molekulare të të dashurisë dhe respektit. Pas kësaj teorie interesante, flet me pasion soaring menaxheri **Tibor Éliás** për një nga fushat më të preferuara të tij, për produktet e bletës. Mjalti, poleni, qumështi dhe propolisi i bletës janë për organizmin, burim i paçmuar i lëndëve minerale. Ekstratet e tyre përmbajnë energji të jashtzakonshme, një tabletë e tillë e vetme përmban 375 miligram propolis! Propolisi jo vetëm dizinfekton, ngihmon organet e tretjes, por shërben edhe si mbrojtës i sipërfaqeve mukozale nga çdo lloj infeksioni.

Është një e dhënë trishtuese që në çdo 3 çifte njëri ka probleme të moslindjes fëmijë, ku shumë herë nuk spjegohet as shkaku. Nqse mjekët shumë herë nuk e gjejnë shkakun, është e sigurtë që kjo vjen nga ushqyerja jo si duhet, nga thithja e lëndëve helmuese dhe nga faktorët e shumtë të stresit që janë karakteristike e jetës sonë në ditët e sotme që nuk ka shërim për këtë gjë. Senior menaxherja **Ferencné Tanács**, si konsulente, në radhë të parë synon kompensimin e mungesave,


domethënë ti sigurojmë organizmit gjithë vitaminat dhe lëndët minerale të rëndësishme, nevojat e duhura me acid folik, hekur, dhe aminoacide. Në qoftë se nuk bëjmë këtë, foshnja do ta marrë ato që ka nevojë nga organizmi i nënës. Përveç kësaj baza esenciale e mbetjes me barrë është sistemi hormonal i ekuilibruar. – Do të doja që çiftet të marrin pjesë bashkë në këto programe sepse është një pergjegjsi e përbashkët. Në qoftë se veprimtaria jonë ka sukses dhe arrihet mbetja me barrë, atë duhet ta ndjekim hap pas hapi.

Në Forever tradicionalisht ka shumë rrjetndërtues me diplomën e mjekut, por pak dimë për dilemat e profesionit të tyre. **Dr Andre Seres** si kirurg dhe

**Dr Katalin Pirkhoffer Seresné** si mjekë pathologe dhe mjekë familje, kur u njohën me Foreverin ishin në të njëjtën situatë vendimmarrje. Më në fund morën një vendim të mirë dhe këtë na i tregon ajo që ata qëndrojnë në skenë si zafir menaxherë. „Duhet të bindeshim që mjekimi jo për gjithshka e di zgjidhjen. Doja ndryshim , por për këtë duhej forcë dhe mbështetje familjare, thotë Andre Seres. – Biznesi ynë u rrit me shpejtësi të madhe dhe qysh nga ajo kohë është transformuar gjithshka. Na besoni, nuk ka nevojë të jesh zheni, mjafton të kërkonin ata që dëshirojnë një jetë më të mirë. Janë të shumtë ata që e kërkojnë atë, ata pas të cilëve do të mund të qëndronim. Tu

japim atyre një shans, një mundësi. Detyra jonë e vetme është ti bëjmë njerzit të sukseshëm, dhe na besoni dhe paratë do të vijnë” – marrim si model nga ky çift. Një sistem imuniteti i përsosur, kjo është dëshira e të gjithë neve. **Dr Ilona Juronics Vargáné**, mjekë pediatre, soaring menaxhere e di këtë sekret. Edhe këtu si në çdo fushë tjetër, bazat duhet ti hedhim që në fëmijëri. Por kjo nuk varet nga moshja e ritur e shëndetshme, por tashmë duhet mbrojtur edhe fëmijët. Sikurse na bën të njohur Dr Ilona Juronics, tashmë që në moshën foshnjore ndeshemi shpesh me probleme të rrugëve të frymëmarrjes, me alergjinë dhe me probleme të lëkurës, por sa e pabesueshme të duket, që në fëmijëri shfaqet ostoporoza dhe problemet e qarkullimit të gjakut e të organeve të tretjes. „Zgjidhjen njerzit e presin nga mjekët, ndëkohë që e kanë vetë në dorë. Prandaj jo më kot edhe unë vetë kam kaluar nga ilaçet tek plotësuesit dietikë.”





Dr. Ilona Juronics tashmë na përmendi faktin e frikshëm që disa „sëmundje të rriturve“ janë shfaqur si simptoma të hapura që në moshën e fëmijërisë. **Dr. Mária Hocsi** tashmë na i përforcon këtë nga fusha e specialitetit të vet. Si diabetologe për kurimin e fëmijëve, menaxherja na flet për sëmundjen e sheqerit dhe komplikacionet e saj si dhe për mënyrat e mundshme të parandalimit. Sikurse na tregon ajo, gjatë 10 vjetëve të fundit është rritur shumë numuri i diagnozave të tilla tek fëmijët nën 3 vjeç, plus kësaj kjo sëmundje paraqitet në forma gjithnjë e më të rrezikshme. Shumë herë e konstatojmë vonë gjëndjen, duke vështirësuar edhe kurimin e fëmijëve. Për shkak të gjithë këtyre më e mira do të ishte në qoftë se parandalimi do të fillonte tek nënat e reja.

**Dr. Terézia Samu**, soaring menaxhere na vjen e paisur në mënyrë të habitshme: me uniformën jeshle të sallës së operacionit dhe maskën e gojës, paisjet e profesionit origjinal të saj. Kostumin e heq shpejt dhe e dimë pse Terézia e ndërroi për Foreverin tavolinën e dhe bisturinë e operacionit. Si kirurge e venave e ndjente veten si një mekanik tubash, që riparonte pjesën e tubit me difekt në punën e zjrrfiksit, por që për pacientët pas kësaj s'mund të bënte asgjë prej gjëje për parandalimin dhe këshillimin e tyre. Në leksionin e saj na flet për bimë medicinale të njohura në shekuj, për vetitë e tyre në mbrojtjen e venave dhe ruajtjen e shëndetit, sikurse janë ginko biloba, hudhra dhe kërpudha reishi të cilat mund të na ndihmojnë të jemi më të shëndetshëm.

**István Halmi**, zafir menaxher dhe **Miklós Berkics**, diamant menaxher, ndajnë skenën. Sikurse na tregojnë, edhe në ditën e shëndetit të vitit të kaluar po kështu qëndruan këtu si lektorë mbyllës të aktivitetit Fillojnë të shprehin me zë menimimet e tyre se kush ka dhe çfarë është pasuria. Istvan ka dy djem, një bashkshorte të mrekullueshme, burim i pasurisë është familja, ndërsa Miklós thekson se prej 15 vjetësh e ndjen veten të pasur sepse konsumon produktet Forever dhe është i shëndetshëm. „Çdo të bëje po të fitoje në loto?“ – e pyet atë Istvani. „Këtë që bëj sot do të bëja përsëri sepse vetë Foreveri është lloja maksimale“ –përgjigjet Miklós, pastaj me një detyrim shoqëror arrin që Istvani të deklarojë : „Në Gusht të vitit 2012 do të jem zafir menaxher!“

Në Ditën e Shëndetit të ardhshme, do të marrim vesh a e mbajti premtimin Istvani. Forever Living pret me dashuri gjithë të interesuarit!





**Falnderim i veçantë i takon lektorëve të Shoqatës të Mjekësisë Alternative Hungareze për pjesmarrjen në këtë aktivitet për përcjelljen tek publiku të mjekimit të lindjes së largme mbi bazat e terapisë Hammer (çekiçi), feng shui, dhe idetë holistike!**

„Jam e befasuar , sa i shumllojshëm ky program, sa ekspozantë dhe interesantë ishin lektorët. Jam prej 9 vitesh konsumatore e rregullt e këtyre produkteve. Seriozisht nuk kam asnjë ankesë, vetëm se niveli im i dhjamit të trupit është më i madh nga nevoja. Kam ardhur me grupin, ky është një takim i një profili pak ndryshe nga Dita e Suksesit, dhe këtu mund të sjellësh ata që në radhë të parë janë të interesuar për ruajtjen e shëndetit dhe që ndoshta akoma nuk mendojnë për ndërtim rrjeti.”  
**Beatrix Országh Nagyné, Budapest**

„Dëgjova leksionet dhe po dhuroj gjak . Bashkshortja ime infermiere më propozoi që ne burrat duhet të japim shëmbullin. Jam kurues masazhist, me profesionin tim angazhohem me perkushtim për preventimin, deri sot isha në të gjitha Ditët e Shëndetit.”  
**Imre Bara - supervizor, Budapest**

„Mendoj se njerzit duhet ti mësojmë se si mund të jetojnë të shëndetshëm. Këtu duket madhështia e Foreverit, sa e sinqertë dhe e hapur, që aktivitete të tilla të mund ti shikojnë të gjithë”  
**Gyuláné Kovács, menaxhere, Békéscsaba**

„Ky takim u thot njerzve, pastër dhe thjeshtë, atë që duhet ta theksojmë disa herë: se duhet të kujdesemi shumë për shëndetin.”  
**Károlyné Birgány, supervizore, Baracska**

„Në radhë të parë jam kurioz për gjëndjen shëndetsore, doja të dija në ç’gjendje është organizmi im, dhe çfarë mund të bëj për të plotësuar mungesat e mundshme.”  
**Márti Molnár supervizor, Budapest**

„Si në Ditën e Suksesit ashtu edhe në Ditën e Shëndetit ishim këtu bashkë me bebin tonë 3 muajsh. Ajo është e urtë, është fëmi i mirë, duron, sipas meje ajo në të ardhmen do të jetë diamant! (Shresoj që edhe unë të parakaloj). Duam të jemi këtu, midis njerzve pozitiv. Pamë mbrëmjen parti të pijes FAB, shfaqjen me mjalt, pamë sistemin e pastrimit të ujit dhe blemë libra, por për një kontroll mjekësor të përgjithshëm nuk patëm nevojë, sepse pre vitesh konsumojmë produktet e FLP”  
**Zoltán Pallai, menaxher, Szigetszentmiklós**

**Falnderojmë përkthyesit me shënja për punën e palodhur, ku gjatë dy ditëve ndihmuan bashkpunëtorët tanë me vështrësi dëgjimi!**



Mbas një jave do të lind fëmijën, kështu që Ditën e Suksesit e pash në internet, por në Ditën e Shëndetit erdha, nuk doja ta humbisja këtë rast. Ndihem shumë mirë, hodha sytë përreth, bisedova me të njohur, ky takim është i mirë edhe për krijim lidhjesh të reja. Vjet mora këtu këshilla të mira për barrën, sigurisht falë edhe kësaj rezultati është i mirë: kjo është barra ime e dytë, e para ishte me rrjedhë krejt ndryshe.”  
**Krisztina Dobos, supervizore, Budapest**

LJUBJANË, 31.03.2012

# Success Day

MUND TË ISHTE NJË E  
SHTUNË E ZAKONSHME  
NË JETËN E NJERËZVE  
TË ZAKONSHËM. MUND  
TË ISHTE EDHE NJË MES  
DITËVE QË SHKOJNË  
DËM PARA TELEVIZORIT.  
MUND TË QANIM SI  
REZULTAT I VËSHTIRËSIVE  
TË PAPËRBALLUESHME  
EKONOMIKE DHE POLITIKE  
QË JANË REALE PËR  
SHUMICËN... DHE JAM I  
SIGURT, QË KJO DO TË  
MBETET EDHE NJË DITË JO E  
KËNDËSHME PËR ATA.

**P**or jo për ne, as për ata, që u mblodhëm përsëri bashkë në hotelin Lev në Ditën e Suksestit. Arritëm me zemër të hapur, të kthjellët dhe të mbushur me shpresë. Këtu gjejmë gjithmonë shtrëngim duarsh me ngrohtësi, argëtim dhe sigurisht një theks të veçantë kushtuam për mësimin dhe trajnimin. Suksesi kërkon ata, që shkojnë përpara, ata që për interes të suksesit janë gati të investojnë energjin, njohuritë, këmbënguljen dhe atë që që është më e çmuara në ditët tona: KOHËN.

